

VENDIM
Nr. 209, datë 20.4.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 60, DATË 31.1.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME PËR VITIN 2018 NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- I. Në vendimin nr. 60, datë 31.1.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:
1. Në pikën 1, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet “... 1 789 punonjës.”.
 2. Në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur vendimit, që përmendet në pikën 1 të tij, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
 - a) Shtohen ndarjet “Gr.1 Presidenca” dhe “Gr.63 Këshilli i Lartë i Drejtësisë”, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 - b) Në ndarjet “Gr.10, Ministria e Financave dhe Ekonomisë”, “Gr.16, Ministria e Brendshme”, “Gr.26, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit”, “Gr.29, Zyra e administrimit të buxhetit gjyqësor” dhe “Gr.78, institucione të tjera qeveritare”, shtohet nëndarja përkatëse, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 - c) Kohëzgjatja ditore për disa nga punonjësit e kontraktuar në sistemin e doganave bëhet 6 orë/ditë, sipas përcaktimit të titullarit të institucionit.
 3. Në pikën 2, pas fjalëve “... specialistët e Agjencisë së Prokurimit Publik ...” shtohen “... inspektor në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave” dhe “... specialist në Sekretariatit Teknik të Komisionit të Dhënies së Dëshmisë së Statusit të Naftëtarit”.
- II. Mbulimi i efekteve financiare për punonjësit e kontraktuar bëhet nga shpenzimet korrente të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2018, të njësive të qeverisjes qendrore.
- III. Ngarkohen ministritë dhe institucionet e përmendura në këtë vendim të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë detajimin e numrit të punonjësve, kategorinë përkatëse të pagës dhe burimin e financimit të tyre.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Gr.	Emri i Institucionit	Numri punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
1	Presidenca	3			
	Aparati i Presidencës	2	Punonjës pastrimi	4 orë/ditë	prill-dhjetor
	Aparati i Presidencës	1	Teknik	4 orë/ditë	prill-dhjetor
6	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	6			
	Aparati i ministrisë	2	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	Sekretariati Teknik (per Statusin e Naftëtarit)	4	Specialistë	8 orë/ditë	vjetore
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	7			
	Aparati i Ministrisë	2	Sanitar	4 orë/ditë	prill-dhjetor
	Drejtorja e Përgjithshme Akreditimit	1	Sanitar	6 orë/ditë	prill-dhjetor
	Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë (në rrethe)	3	Sanitar	4 orë/ditë	prill-dhjetor
	Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë	1	Sanitar	6 orë/ditë	prill-dhjetor
16	Ministria e Brendshme	2			
	Prefektura Tiranë	1	Arkivist	6 orë/ditë	prill-dhjetor
	Prefektura Vlorë	1	Punonjës arkiv- protokolli	8 orë/ditë	6-muaj
26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	6			
	Agjencia Kombetare e Bregdetit	6	Operatorë	8 orë/ditë	6-muaj (prill-shtator)
29	Zyra Administrimit të Buxhetit Gjyqësor	3			
	Gjykata Administrative e Apelit Tiranë	3	Specialistë	8 orë/ditë	6-muaj
63	Këshilli i Lartë i Drejtësisë	8			
	Administrata dhe Inspektoriati i institucionit	2	Punonjës arkiv- protokolli	6 orë/ditë	prill-dhjetor
	Administrata dhe Inspektoriati i institucionit	6	Operatorë	6 orë/ditë	prill-dhjetor
76	Inspektoriati i Lartë Kontrollit të Deklarimit të Pasurive	1			
	Aparati	1	Inspektor	8 orë/ditë	prill-dhjetor
87	Institucione te tjera qeveritare	1			
	Agjencia për Zhvillim Rajonal 4	1	Sanitar	6 orë/ditë	prill-dhjetor
	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	37			